



VENDIM

Nr. 123, Datë 21.07.2016

MBI

**MIRATIMIN E LICENSËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË
TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “dh”; 38 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96 date 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike, për miratimin e licensës për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike dhe draftin përkatës,

Konstatoi se:

- Me vendimin Nr. 4, datë 27.01.2016, Bordi i ERE ka miratuar fillimin e procedurës për miratimin e licensës për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.
- Në lidhje me këtë licensë është kryer edhe procesi i konsultimit me palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Licensën për veprimtarinë e Operimit të Tregut të Energjisë elektrike.(licenca e operimit të tregut bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

https://www.ere.gov.al/doc/LICENSA_E_OPERATORIT_TE_TREGUT_TE_ENERGJISE_ELEKTRIKE-_miratuar_me_V_123_dt_21.07.2016.pdf